



Viti i XIV-të i Botimit, Nr. 2,

Dhjetor 2022

SOCIALIZMI SHQIPTAR DHE PROJEKTIMI I TIJ BAZUAR NË FRYMËZIMIN STALINIST

Agron Mesi

* Instituti Antropologjisë Kulturore dhe Studimeve të Artit,

Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë

Pedagog i ftuar në Departamentin e Art Dizajnit,

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University, Tiranë.

Përmbledhje

Ky punim trajton aspekte të socializmit si ideologji e cila u ngjiz fillimisht në Europën perëndimore të shekullit XIX. Alternativa socialiste doli në skenë në vazhde të modernizimit të aktivitetit prodhues industrial kapitalist dhe paralelisht më të, të afirmimit të mendimit modern intelektual në fushat e estetikës, të arteve, të diskursit filozofik e të kërkimeve shkencore. Që në fillimet e tij, socializmi u projektua si një dinamikë e re politike, ekonomike dhe shoqërore e aftë për të kapërcyer dhe zgjidhur problemet komplekse që solli sistemi kapitalist në kryeqendrat më të zhvilluara të tij. Por, nuk vonoi shumë, dhe ky propozim iu përshtat një game të gjerë shoqërisht njerëzore, edhe atyre me zhvillim të ulët industrial dhe shoqëror, apo dhe atyre të pozicionuara gjeografikisht jashtë territorit perëndimor europian, duke shfaqur për këtë arsye forma dhe përmasa të ndryshme aplikimi përgjatë gjithë shekullit XX.

Edhe shteti partiak që sundoi në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore do të zgjedhë *socializmin* si sistemin e duhur për rrugëtimin e vendit dhe të shoqërisë drejt modernizimit të tyre. Për të arritur këtë modernizimin socialist të përgjithshëm, shteti dhe lidhshipi shqiptar u frymëzuan nga eksperiencia sovjetike *staliniste*. Rasti i socializmit shqiptar dhe formësimi që mori i gjithë procesi i modernizimit politik, ekonomik, kulturor dhe shoqëror, më shumë sesa pjesë e variantit të përgjithshëm lindor, përafrohet apo mbart tipologji me variantin e socializmit totalitar sovjetik të periudhës staliniste të viteve 1925-1955.

Fjalë çelës: *modernizim socialist, frymëzim stalinist, totalitarizëm, parti-shtet, centralizim.*

ALBANIAN SOCIALISM AND ITS STALINIST-INSPIRED PROJECTION

Abstract

This survey considers different aspects of socialism that as an ideology was first conceived in Western Europe in the 19th century. The socialist alternative emerged in the context of the modernization of capitalist industrial production activity and, in parallel, the affirmation of modern intellectual thought in the fields of aesthetics, arts, philosophical discourse and scientific research. From its beginnings, Socialism was designed as a new political, economic and social dynamic capable of overcoming and solving the complex problems that the capitalist system brought to its most developed centers. But, it didn't take long, and this proposal was adapted to a wide range of human societies, even those not yet sufficiently developed industrially and not so culturally modernized, or those geographically positioned outside the Western European territory, showing for this reason forms and different sizes of application throughout the 20th century.

Also the single party state that will rule in Albania after the Second World War will choose socialism as the right system for the journey of the country and society towards their modernization. In order to achieve the socialist modernization of the whole world, the Albanian state and leadership were inspired by the Soviet Stalinist experience.

The case of Albanian socialism and the shape that the whole process of political, economic, cultural and social modernization took, more than part of the general eastern variant, is aligned or bears typology with the variant of Soviet totalitarian socialism of the Stalinist period of 1925-1955.

Keywords: *socialist modernization, stalinist inspiration, totalitarianism, single party-state, centralization.*

1. Hyrje

Historia ndërmjet dhe pas dy luftave botërore, na ofron një masë të gjerë konceptimesh dhe materializimesh të ideve dhe aspiratave socialiste, të eksperimentuara në një numër të madh vendesh e shoqëri njerëzore. Kapitalizmi humbi kredibilitetin e tij ndërkombëtar si sistem ekonomik, politik e social, sidomos me krizat financiare të fundviteve '20 e fillimviteve '30, dhe po kështu edhe demokracitë liberale europiano-perëndimore u paraqitën pikërisht në këtë periudhë të pa afta për të ndaluar Frankon, Hitlerin e Musolinit para se të provokonin kasaphanën e dytë botërore. Paralelisht me këto zhvillime europiane dhe botërore, nga ana tjetër, socializmi dha rezultate të frutshme në aplikimin e tij si sistem ekonomik shtetëror në Bashkimin Sovjetik, dhe njëkohësisht vetë Stalini u shfaq para vendit të tij dhe mbarë Europës e botës si *një udhëheqës shpëtimtar e vizionar i së ardhmes*. Pretendimi se marksizëm-leninizmi ishte ideologjia më progresive e kohës e destinuar drejt së ardhmes, nuk dukej dhe aq i pamundur në këtë kohë zhvillimesh të vullshme historike e po aq edhe dramatik. Një tregues i fuqisë shkencore dhe emancipuese të kësaj ideje përparimtare të majtë dhe praktike premtuese sociale ishte edhe joshja e deri bërja përkrahës të flaktë të saj e shumë intelektualëve kudo në Europë, si në Lindje po ashtu dhe në Perëndim. Në Bashkimin Sovjetik komunizmi përfitoi gjithashtu dhe nga arritjet e dukshme nacionaliste që i ishin atribuar atij. Forcat reaksionare vendase dhe pushtuesit e huaj ishin mposhtur, dhe pas fitores në vend ishte vendosur uniteti ndër etnik. Me gjithë problemet e shumta me të cilat u përball para dhe pas luftës regjimi stalinist, në Bashkimin Sovjetik vihej re qartazi një rritje ekonomike dhe një progres i jashtëzakonshëm krahasuar me të kaluarën cariste [1].

Bolshevizmi dhe stalinizmi qenë nga format më ekstreme të konkretizimit të ideve socialiste, që përfshinë pas Luftës së Dytë Botërore të gjithë Europën Lindore dhe një pjesë të Ballkanit Perëndimor. Duke u shumfishuar në variante të ndryshme kombëtare, etnike e multietnike, por të gjitha me referim ideologjinë marksiste-leniniste dhe metodën staliniste. Social-komunizmi u përhap në Europë dhe në botë me cinizmin e një force brutale e të pamëshirshme, por njëkohësisht dhe me joshjen e një doktrine që paraqitej njëkohësisht si shkencë, si fe dhe si fuqi politike, duke premtuar *çlirim*, emancipim e barazi për të gjithë popujt [2]. Socializmi, me format e ndryshme që ai mori përgjatë shekullit të XX, që nga diktaturat komuniste e deri tek social-demokracitë, pati një ndikim me rëndësi specifike mbi shumë shoqëri njerëzore, duke i ofruar atyre modele alternative komplekse të modernitetit [3].

2. Diskutim

Edhe shteti partiak që do të sundojë në Shqipëri pas luftës së Dytë Botërore do të zgjedhë *socializmin* si sistemin e duhur për rrugëtimin e vendit dhe të shoqërisë drejt modernizimit. Sipas studiuesit të ekonomisë politike të rastit shqiptar, Andy Schnytzer, shteti dhe lidershipi shqiptar u frymëzuan direkt nga eksperiencia *staliniste* për modernizimin socialist të shoqërisë dhe të vendit [4]. Rasti i socializmit shqiptar dhe formësimi që mori i gjithë procesi i modernizimit politik, ekonomik, kulturor dhe social, më shumë sesa pjesë e variantit të përgjithshëm lindor të socializmit, mbart tipologji apo përngjason me variantin tridhjetë vjeçar të socializmit sovjetik të periudhës totalitare staliniste të viteve 1925-1955.

Në mungesë të një përvoje të mëparshme teoriko-shkencore, dhe aq më pak praktike, në lidhje me lëvizjet dhe platformat socialiste të propozuara në hapësirën europiano-perëndimore në fundin e shekullit të XIX dhe sidomos në gjysmën e parë të shekullit të XX, pushtetarët shqiptarë të pasluftës ndoqën me përpikmëri pothuajse të gjitha konceptet, stadet dhe metodat ekstreme të instalimit në vend të një sistemi tërësisht të ri dhe pa vijueshmëri me të kaluarën, po ashtu siç kishte ndodhur në rastin bolshevik rus të pas revolucionit të Tetorit.

Përafria e variantit shqiptar me atë sovjetik fillon që me strukturën sociale dhe stadin e zhvillimit që trashëgohej nga e kaluara e afërt dhe e largët. Ashtu si revolucioni bolshevik u mbështet te fshatarësia si shtresë dominuese e popullsisë, po ashtu dhe Partia Komuniste Shqiptare dhe pushteti i pas luftës, në mungesë të një shumice proletare të konsoliduar në stadin e një klase të mirëfilltë si bazë e revolucionit tipik socialist, mori tiparet e variantit të revolucionit bolshevik leninist. Edhe vetë kjo përvojë e hershme lindore, në mungesë të zhvillimit kapitalist të vendit, ishte konceptuar si një shartim i platformës *bakuiniste* (që mbështeste parësinë e rolit të shtresave të pazhvilluara, siç ishte fshatarësia agrare), e miksuar nga Lenini me teorinë *marksiste* të nevojës së domosdoshme të një partie në krye, si udhëheqëse e revoltës së armatosur popullore dhe e ndërtimit të shoqërisë së re socialiste në vijimësi.

Pas Revolucionit të Tetorit, bota do të kishte praktikën e një shoqërie për ndërtimin e socializmit dhe projektimin e rrugës drejt komunizmit nëpërmjet instrumentesh krejtësisht shtetërorë. Modeli i ndërtimit të socializmit në një vend të vetëm, pasi shteti kontrollohet nga partia që përfaqëson interes të shtresave të gjera të popullsisë dhe kryesisht të klasës punëtore, intensifikohet dhe merr një trajtë të re prej periudhës së Stalinit, i cili i dha jetë logjikës së planit, si instrumenti kryesor shtetëror për ndryshimin rrënjësor të shoqërisë [5]. Pas Luftës së Dytë Botërore, modeli që u aplikua, ku me ndryshime domethënëse e ku me ndryshime vetëm gjuhësore, në vendet që do të formonin përgjatë gjithë shekullit të XX të ashtuquajturin Kampin ose Bllokun socialist, do të ishte ai i socializmit shtetëror dhe të planifikuar [6].

Ekonomia politike e shtetit shqiptar të pas luftës u bazua në disa parime teoriko-konceptuale sovjetike, si:

- Partia Komuniste, duke marrë rolin e përfaqësueses së interesave të shtresave të gjera popullore, me në krye liderin e saj, do të udhëheqë vendin e vetme dhe pa e ndarë me asnjë alternativë tjetër pushtetin politiko-ekonomik.
- Nëpërmjet mekanizmave të shtetit do të shoqërizohen të gjitha mjetet e prodhimit.
- Planifikimi qendror i kompozuar nga shteti do të zëvendësojë mekanizmat e prodhimit privat dhe të tregut të lirë konkurrues.
- Prona private do të eliminohet sa më shumë që të jetë e mundur duke u zëvendësuar me pronën shoqërore.
- Menaxhimi i të ardhurave kombëtare, shpërndarja e të mirave materiale dhe e shërbimeve publike do të bëhen të barabarta dhe do të ekzekutohen apo mbikqyren nga vetë shteti nëpërmjet mekanizmave të tij [7].

Modeli *socialist shtetëror stalinist* do të propogandohej dhe mbahej nga udhëheqja komuniste shqiptare si modeli më i përshtatshëm, më i mirë dhe më i sigurt për të arritur konsolidimin e rendit dhe modernizimin e përgjithshëm të vendit e të mbarë shoqërisë për arsye të disa veçorive të përbashkëta të statusit shoqëror dhe ekonomik të fillesës së rrugëtimit, pasi të dy vendet, si Shqipëria po ashtu dhe Rusia, megjithëse me ndryshime specifike të mëdha, ndanin përbashkësinë e territorit përgjithësisht rural pa trashëgimi industriale, pa klasë punëtore të konsoliduar, me shumicë determinuese popullsi fshatare dhe masivisht të paarsimuar.

Stalinizmi cilësohet në analizën politiko-historike të sotme si një *tirani shtetërore*, që lindi nga problemet komplekse të perandorisë multietnike socialiste sovjetike të pas Revolucionit të Tetorit, por që nuk gjeti rastësisht gjenin e saj negativ tek figura diktatoriale e Stalinit. Stalini, jo vetëm që provoi t'i zgjidhë problemet e ndërlikuara multietnike e klasore me *ushtrimin e dhunës shtetërore e mbjelljen e terrorit policesk*, por përjetoi madje dhe një *kënaqësi perverse* në ushtrimin e tyre [8]. Diktatura ishte mënyra e sundimit bolshevik që prej fillimit të tij, e ushtruar nëpërmjet Partisë. Megjithatë deri para ardhjes në pushtet të Stalinit, në partinë leniniste egzistonte debati dhe ballafaqimi i mendimeve ndryshe. Por me Stalinin kjo alternativë ndryshoi, diktatura e Partisë Bolshevike u shndërrua në një diktaturë personale të vetë udhëheqësit, pasi ai nënshtrroi dhe vendosi nën terror edhe vetë partinë e tij. Stalini largoi dhe eliminoi deri fizikisht çdo kundërshtar parimor të tij, duke u bërë kështu diktatori i parë i kampit socialist, por jo i vetmi në vijimësi.

Edhe lideri shqiptar i pas luftës, Enver Hoxha, menjëherë sa erdhi në pushtet prezantoi të njëjtën mendësi totalitare dhe ndoqi po të njëjtën skemë diktatoriale eliminimi të mendimit ndryshe brenda partisë. Dënimet politike ekstreme, deri në ekzekutime, të fraksioneve reale të fillim viteve të pluralizmit të brishtë të luftës dhe pas luftës, dhe ato të shpikura të viteve monopartiake në vazhdim, e dëshmojnë më së miri modelin diktatorial me frymëzim stalinist të Hoxhës, i vënë në krye të udhëheqjes së partisë e të shtetit me manipulime e terror.

Duke i forcuar përfundimisht pozitat, pas një faze shumë të shkurtër pluralizmi nistor që shpejt ia la vendin largimit të dhunshëm të të gjithë kundërshtarëve politikë, Hoxha hodhi bazat e një pushteti sa despotik aq dhe absolut, nëpërmjet krijimit të një klime dyshimi dhe mosbesimi të përhapur në tërë shtresat shoqërore të vendit, si dhe nëpërmjet dhunës së vazhdueshme që arriti deri në asgjësimin fizik, viktimë e të cilës ranë jo vetëm kundërshtarët e shpallur, por “...jo rrallë dhe vetë shokët besnikë të partisë.”- shprehet studjuesi bashkohor i rastit shqiptar, Paolo Rago [9].

Ideologjia ndikoi fuqishëm në këndvështrimin e Stalinit ndaj botës dhe shoqërisë njerëzore, si dhe u përdor për legjitimimin e veprimeve diktatoriale të tij. *Ideologjia Markste-Leniniste* ishte një krijesë e vetë Stalinit, dhe në diskursin politiko-ideologjik të majtë të kohës, Stalini mori rolin e trashëgimtarit dhe interpretuesit të plotfuqishëm të mësimave të klasikëve të doktrinës komuniste dhe materializuesit të praktikës së socializmit shtetëror.

Në fillim të viteve '30 Stalini shpalli eliminimin e kulakëve si klasë. Po kështu dhe pse reforma agrare s'kishte pak që ishte ndërmarrë, nuk vonoi dhe menjëherë u lançua kolektivizimi i bujqësisë, në fillim me bindje e dëshirë dhe shumë shpejt, pa u deklaruar por tepër dukshëm, me linçim, detyrim e presion. Megjithatë kolektivizimi i bujqësisë rezultoi një dështim i politikës agrare staliniste që solli deri zinë e bukës e urinë vdekjeprurëse të viteve '32-'33, Stalinit i interesonte më shumë kontrollimi, shtetëzimi dhe proletarizimi i fshatit, prandaj dhe ai e propagandoi hapur kolektivizimin si një triumf të politikave lidhur me ndërtimin shtetëror të socializmit.

E njëjta dinamikë, pa nxjerë aspak mësim të hidhura nga kjo përvojë e dyshimtë, ajo kopjohet nga Hoxha, rreth njëzet vjet më vonë, për t'u eksperimentuar mbi kurrizin e fshatarësisë shqiptare në politikën agrare shtetërore të viteve '45-'60.

Të gjitha objektivat që qeveria e Hoxhës i vuri vetes menjëherë pas ardhjes në pushtet, u huazuan nga modeli stalinist i socializmit sovjetik të periudhës mes dy luftimeve botërore. Të tilla qenë industrializimi i përshpejtuar i vendit dhe krijimi i klasës punëtore, dy procese apo dukuri, të cilat ashtu si në Bashkimin Sovjetik të pas revolucionit, nuk ekzistonin edhe në Shqipërinë e pas çlirimit, prandaj dhe duheshin krijuar me urgjencë e deri artificiaisht nga e para. Po kështu, reforma agrare, dhe pothuajse pa mbaruar mirë ajo, kolektivizimi i tokës bujqësore, si një hap i ndërmjetëm drejt shtetëzimit të saj të plotë në vijim po nga shteti "*dhurues*", janë pasqyrim identik i etapave të politikës agrare sovjetike staliniste. Krijimi i ekonomisë së planifikuar dhe kundërvënja e saj ndaj tregut të lirë deri në asgjësimin e plotë të tij, si dhe konfiskimi i dhunshëm i pasurive, janë po imitim i politikave ekonomike sovjetike, me tërë rreptësinë dhe fanatizmin e tyre stalinist.

Terrori policor i instaluar nga Stalini në vitet '30-'40 në Bashkimin Sovjetik me krijimin e strukturave kontrolluese partiake mbishtetërore, dhe njëkohësisht dhe të atyre mbi partiake e të vendosjes së kultit të tij edhe mbi vetë këto të fundit, instaloj atë që u njoh si "*kulti i individit*". Ndonëse merita e fillesës edhe për këtë fenomen diktatorial i njihet Stalinit, pas Luftës së Dytë dhe brenda Bllokut Lindor, "*kulti i individit*" do të "*përsosej*" nga shumë liderë të të ashtëquajturave "*Demokraci Popullore*". Hoxha do të jetë një ndër ata diktatorë që do ta çonte më tej, dhe fatkeqësisht do ta pasuronte me nuanca të tjera personale perversiteti, kompleksiteti e fobie, institucionin e "*kultit të individit stalinist*" duke na "*dhuruar*" "*enverizmin*" shqiptar. Krijimi i strukturave paralele apo mbi shtetërore, si "*Ministria e Brendshme*", apo të atyre mbi partiake, si "*Sigurimi i Shtetit*", dhe vendosja e vetë autokracisë së Hoxhës mbi gjithçka, nuk janë gjë tjetër veçse shembuj diktatorial të klonuar si kopje të deformuara të origjinaleve të shëmtuara staliniste. Po kështu dënimet dhe ekzekutimet pa gjyq të kundërshtarëve, burgjet politike, ideja e kampeve të punës dhe të internimit, të njohura me emrin famëkeq të "*gulagut*" siberian, u kopjuan nga Hoxha në versionin e gjyqjeve të inskenuara, të dënimeve pa gjyq, të ekzekutimeve në Malin me Gropa, të burgjeve politike dhe njëkohësisht të kampeve të punës si ai i Spaçit të Tepelenës, të internimeve e izolimeve rurale të Savrës e Torovicës, etj.

Studiuesi shqiptar Piro Misha, e përcakton më kompleks dhe përtej stalinist këtë sistem dhe këtë logjikë totalitare shqiptare. Sipas tij, social-komunizmi shqiptar përbënte një hibridizim të çuditshëm mes dëshirës së sinqertë për modernizimin e shoqërisë së prapambetur shqiptare, ideologjisë idealiste marksiste-leniniste, brutalizmit stalinist, radikalizmit kinez, retorikës megalomane, etj. dhe mendësive e

shprehive të botës konservatore e të prapambetur provinciale shqiptare [10]. Po kështu, një tjetër analist i sotëm, akademiku Artan Fuga, e paraqet apo interpreton mbijetesën e pacënuar të këtij sistemi për shumë kohë, derisa ai në fund më shumë ra vetë se e hodhën: *“Logjika e një pushteti totalitar ose autoritar... është mjaft e pranishme në disa tradita kulturore që ekzistojnë në gjirin e shoqërisë tradicionale shqiptare. Pikërisht në këto tradita kulturore u mbështet pushteti totalitar, për t’u përligjur si i tillë për një kohë të gjatë. Kështu, modeli stalinist i pushtetit politik nuk qe diçka që u vendos thjesht me dhunë, ai gjeti gjithashtu disa struktura kulturore të gatshme, të cilat i dhanë mundësi atij...të mos rrefuzohej...që në hapat e parë”* [11].

Në konsolidimin e pushtetit dhe të aprovimit popullor të tij, nga ana e elitës drejtuese partiako-shtetërore shqiptare u përdor një politikë dhe demagogji sa e koklavitur po aq dhe dredharake, e cila duke ju përshtatur psikologjisë dhe mënyrës së të menduarit tradicional të shtetasve, ndihmoi në instalimin e një aparati kontrolli dhe hierarkie që dominonte nga lart, apo nga *“më i madhi”*, pikërisht pasi u gjend një terren i përshtatshëm i trashëguar nga e kaluara patriarkale, - do të mbështesë trajtesën dhe studiuesi Paolo Rago [12].

Format që mori aplikimi i stalinizmit në Shqipëri përfaqësohen nga një konceptim totalitar jo vetëm i funksionimit të parisë dhe shtetit, po ç’është më e rënda i të gjithë ekonomisë së vendit, i territorit urban e hapësirës publike, po ashtu dhe i shoqërisë në tërësi e kulturës në veçanti. Kultura, arti dhe dija shken-core u detyruan gjatë gjithë kohës të merrnin rolin e propagandës mbështetëse, afirmuese e legjitimuese të diktaturës së proletarietit. *“Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë është shteti i diktaturës së proletarietit, që shpreh dhe mbron interesat e të gjithë punonjësve...”* [13]. Vetë diktatura si koncept ideologjik, dhe aq më tepër si praktikë shtetërore, në çfarëdo ngjyrimi që shfaqet, motivohet apo justifikohet, paraqitet si totalitare, prandaj dhe periudha kohore prej 45 vitesh e sundimit të partisë-shtet me të drejtë quhet *diktaturë totalitare* në historinë e Shqipërisë [14].

Socializmi shqiptar do të projektohej dhe drejtohej totalisht nga partia-shtet në fuqi. Shteti i kësaj periudhe dhe i këtij sistemi u paraqit si një strukturë monolite e mbështetur mbi bashkekzistencën (por dhe konfliktin hierarkik) të autoritetit të dyfishtë të partisë me shtetin. Por, siç na kujton Hannah Arendt, në një sistem totalitar është vënë re shpesh se marrëdhënia mes dy burimeve të autoritetit, mes shtetit dhe partisë, është një prej autoriteteve më të rreme, pasi makina shtetërore e cila paraqitet zakonisht si një fasadë e fuqishme, mbron dhe fsheh prapa saj autoritetin real absolutisht dominues të partisë [15]. *Pavarësisht se çfarë tradite nacionale kanë, apo nga çfarë burime specifike ideologjike frymëzohen, në përgjithësi qeveritë totalitare janë zhvilluar prej sistemeve një-partiake, - shprehet ajo* [16].

Edhe për sa i përket sintaksës gjuhësore që përdori shteti totalitar shqiptar dhe lideri i saj Hoxha në lidhje me etiketimin e sistemit dhe të doktrinës udhëheqëse, më shumë sesa tek fjalët, kuptimi i saj konkretisht është tek ajo çfarë qendron poshtë apo pas tyre. Duke vërejtur përgjithësisht materialin propagandistik partiako-shtetëror, dhe kryesisht leksikun e liderit udhëheqës Hoxha (i cili merrej apriori dhe si gjuha e partisë dhe e vetë shtetit), periudha e pas çlirimit të vendit u quajt si peridhë e *“ndërtimit socialist të vendit”*, e *“modernizimit të jetës dhe e emancipimit të mbarë shoqërisë”*, e *“ushtrimit të diktaturës së proletarietit”*, e *“udhëheqjes së klasës punëtore”* *“bashkëudhëtare e ngushtë me fshatarësinë”* dhe *“në aleancë me inteligjencën popullore”*, ndërsa *“marksizëm-leninizmi”* u quajt doktrina më *“frymëzuese, ndriçuese”* apo *“fitimtare”*. Termat *“socializëm”*, *“diktaturë proletariati”*, *“shtet i klasës punëtore”* dhe *“marksizëm-leninizmi”* qenë të preferuarit e Hoxhës. Në periudhën e pas luftës, termi *“komunizëm”* me kalimin e kohës u përdor shumë më rrallë nga propaganda dhe vetë diktatori, dhe asnjëherë nuk identifikoi Shqipërinë e asaj periudhe apo sistemin dhe shtetin shqiptar. Vazhdoi të mbijetojë termi *“komunist”* si individ i angazhuar në rradhët e partisë dhe mbrojtës i flaktë i doktrinës, por me kohë dhe ai u dublua me klasifikimin *“anëtar partie”*. Edhe termat e përdorur nga Hoxha e kanë më së shumti origjinën nga importimi sovietik e konkretisht nga leksiku i vetë Stalinit, pasi ai ishte i pari që doktrinën e identifikoi me *“marksizëm-leninizëm”*, sistemin me *“socializëm”* dhe shtetin e ligjin me *“diktaturën e proletarietit”*.

Edhe ne si autorë gjatë tekstit tonë do të kemi kujdes që Shqipëria e kësaj periudhe të trajtohet si *socialiste*, sistemi si *socializëm shtetëror* dhe termi *komunizëm* të përdoret më së shumti në trajtat e *ideologjisë* së zanafillës projektuese e frymëzuese, por jo të vetë sistemit. Duke e parë jo të lehtë këtë ndërmarrje përtej leksikore, e themi këtë pasi sot, jo pak haset një inflacion i madh në lidhje me artikulin e termit *komunizëm* kur bëhet fjalë për Shqipërinë dhe periudhën e viteve 1945-1990. Dhe ky etiketim prek jo vetëm qasjen e huaj studimore ndaj Shqipërisë së periudhës në fjalë, por shpesh përdoret pa u thelluar dhe nga vetë zhargonit i sotëm politik, publicistik apo gazetaresk në vend. Për të huajt më së shumti vërejmë të parapëlqehet përcaktimi (i kthyer në ekzotik tashmë) “*komunizmi shqiptar*”, “*periudha e komunizmit*”, “*diktatura komuniste*”, “*burgjet komuniste*”, “*udhëheqja komuniste*”, etj. Në lidhje me këtë fakt në dukje të pa dëmshëm, por jo pa rëndësi në të kuptuarit, konceptuarit, teorizuarit dhe inkuadruarit historikisht të rastit shqiptar, analisti Romeo Kodra vëren se: “...mesa duket, ndoshta edhe në emër të promovimit të multikulturalitetit plurigjuhësor, një kritiku apo studiuesi të huaj...bashkëkohor të kontekstit shqiptar, i lejohen gafa dhe injoranca të tilla, si ato të përdorimit vend e pa vend të termit dhe konceptit ekzotik “komunist” e “periudhë e komunizmit”, siç e përdorin shpesh herë edhe disa nga përfaqësuesit aktual politikë shqiptarë”. Dhe në vijim, po përsëri ky analist shprehet se: “...nuk ka ekzistuar asnjëherë një Shqipëri komuniste...Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, as vetë Enver Hoxha në deliret e tij më të skajshme megalomaniakale, nuk ka patur guximin, apo ka patur mendjekthjelltësinë, ta quaj si të tillë”[17].

Idea e modernizimit të Shqipërisë duke u mbështetur në modelin socialist dhe udhëhequr sipas planifikimit të centralizuar shtetëror, u mbështet në disa parime, të cilat u shprehën dhe në legjislacionin përkatës në fuqi. Si parësor konsiderohej parimi i “*partishmërisë*”, sipas të cilit legjitimohej roli themeltar i Partisë së Punës [18] në të gjitha proceset e hartimit dhe vënies në zbatim të planeve shtetërore. Neni 3 i Kushtetutës, si akti themeltar i shtetit, përcaktonte qartazi se “*Partia e Punës e Shqipërisë... është forca e vetme politike udhëheqëse e shtetit dhe e shoqërisë*.” Në vazhdim, i lidhur dhe i pandarë nga parimi i mësipërm primar, do të ishte ai i “*centralizimit shtetëror*” të të gjithë jetës ekonomike të vendit dhe të shtetasve, parim që do vendoste monopolin shtetëror në çdo aspekt ekonomik, që nga kontrollimi i mjeteve, mënyrave dhe forcave të prodhimit, po kështu dhe mbi prodhimin e shpërndarjen e të ardhurave. Sipas Nent 25: “*Shteti organizon, drejton e zhvillon tërë jetën ekonomike e shoqërore me plan unik e të përgjithshëm, me qëllim që të plotësohen nevojat materiale e kulturore ...të shoqërisë; të forcohet pavarësia dhe mbrojtja e vendit, duke rritur e përsosur pareshtur prodhimin socialist mbi bazën e teknikës së përparuar*” [19]. Gjithashtu shteti merrej me organizimin e tregut të produkteve për konsum të gjerë, deri në detaje të tilla, si vendosjet e çmimeve, sasitë apo llojshmëritë e mallrave, triskëtimet, listimet ushqimore, etj. Do të ishte po vetë shteti ai që do të përcaktonte dhe nivelin e pagave e të shpërblimeve, emërimet, qarkullimet dhe pushimet nga puna. Po kështu, në fushën sociale e urbane, shteti mori përsipër sfidën e sigurimit të strehimit në masë të gjerë të popullatës, të shkollimit, shërbimin shëndetësor, të argëtimit kolektiv të saj, të trajtimit të hapësirës publike, etj. Parim i rëndësishëm i konceptimit socialist të ndërtimit të Shqipërisë së Re do të ishte “*mbështetja në forcat tona*”, parim i cili diktoi shfrytëzimin maksimal të burimeve materiale dhe njerëzore vendase, si dhe të resurseve të tjera, të atyre teknologjike, natyrore, minerare, etj., po vendase.

Një parim tjetër i socializmit shtetëror shqiptar ishte “*objektiviteti shkencor*”, i cili i argumentonte planet shtetërore si të mirëprojektuara, të mbështetura në logjikën më të saktë shkencore, në atë materialiste dialektike dhe historike, dhe si rrjedhojë të pagabueshme. Bashkëlidhur me të, parimi i “*ligjshmërisë*” do t’i konsideronte direktivat shtetërore ligjërisht të detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjitha organizmat, njësitë ekonomike shtetërore e shtetasit. Parimi i “*përparësisë*” do t’u jepte prioritet disa degëve apo sektorëve të caktuar të ekonomisë dhe prodhimit. Parimi i “*vazhdimësisë*”[20] do të nënvizonte faktin se zhvillimet ekonomike duhen kuptuar dhe trajtuar si procese të shtrira në kohë dhe si stacione të një rrugëtimi të vetëm e të gjatë historicist, me destinacion ndërtimin e plotë dhe me sukses të shoqërisë socialiste, etapë që do t’i hapte rrugën stadi tjetër determinist, afirmimit të shoqërisë ideale komuniste të së ardhmes së lumtur.

Ndrydhja e personalitetit, nënshtrimi i individit, shkrirja e tij në masën amorfe të grupit, kolektiviteti dhe barazitizmi, *shndërrimi gjithnjë i klasave shoqërore në masa dhe turma*, [21], por nga ana tjetër dhe respekti i padiskutueshëm për traditën popullore, për hierarkinë sociale dhe “*më të madhin*”, janë karakteristika të njohura të shteteve totalitare. Kjo lidhje me traditën, sidomos me karakterin e saj *holist* dhe të kontrolluar sipas rregullash jo kollaj të ndryshueshme, do t'i shërbente edhe kulturës totalitare në qëllimet e saj propagandistike, dhe ajo do ta përdorte shpesh si justifikim “*largimin nga tradita*” në ndëshkimin e dukurive të *modernizmit* të shfaqura në kulturë dhe arte. Dimension propagandistik euforik të jetës së lumtur në socializëm, kultura shqiptare do ta marrë, do ta afishojë e amplifikojë me bujë nga modulet stampë të metodës së *realizmit socialist* (një korent ideologjik dhe estetik mediokër ky i importuar nga skena kulturore sovjetike e viteve '30) i cili do të deformonte për shumë vjet kulturën shqiptare në të gjitha fushat e saj. Jeta artistike dhe e gjithë kultura në përgjithësi u organizua përmes një kalendari në përmbajtje dhe formë të parapërgatitur, që mbikqyrej rreptësisht përmes komisionesh shtetërore për devijime apo mangësi ideologjike gjatë zbatimit të tij. Shkenca dhe kultura e shoqërisë shqiptare gjatë periudhës së socializmit, ashtu si modernizimi i vendit, identiteti urban i territorit dhe jeta e shtetasve, u formësuan nën indoktrinimin politik dhe diktatin totalitar shtetëror. Programi i qeverisë komuniste për modernizimin dhe transformimin e Shqipërisë nga një vend i prapambetur bujqësor e gjysmëfeudal në një shoqëri të përparuar industriale, rezultoi në një farë mënyre si një sukses i jashtëzakonshëm për kohën. Brenda disa viteve të para Shqipëria paraqiti nivele më të larta të rritjes ekonomike sesa vetë rritja e popullsisë.[22] Ekonomia përparoi ndjeshëm në disa nga treguesit kryesorë strukturorë të saj, siç qenë zhvillimi i bujqësisë dhe i industrisë, por dhe në ato superstrukturorë, si arsimi, kujdesi shëndetësor, kultura, artet, arkitektura, modernizimi i qyteteve, i infrastrukturës rrugore e shërbimeve, i kushteve të banimit e mënyrës së jetesës, etj. Realisht Shqipëria pësoi ndryshime rrënjësore pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Vendi nisi të marrë përgjithësisht një pamje urbane shumë më moderne krahasuar me të kaluarën, periudhë kjo kur moderniteti kishte arritur të instalohej vetëm në pak pjesë të territorit dhe kryesisht të përqëndrohej në qendrat e qyteteve më kryesore. Lidhur me këtë, studiuesia italiane e rastit shqiptar, Emanuela Fabretti shkruan: “*Regjimi i Hoxhës, në përprjekjen për të vendosur një kohezion të brendshëm që do të sillte ndërtimin e një shteti kombëtar (nëpërmjet frymës së ndezur nacionaliste), solli gjithësesi një zgjerim të pushtetit shtetëror e të drejtimit, një përmirësim të homogjenitetit shoqëror, si dhe krijoi një sistem welfare-i minimal për të gjithë. Gjithashtu, u shënuan përparime në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, po kështu dhe në emancipimin e gruas, e konsideruar si një kontigjent i nevojshëm për sistemin prodhues socialist shtetëror*” [23].

3. Përfundime:

in tonë mund të konkludojmë se në modernizimin e vendit gjatë periudhës së socializmit shtetëror, mjaft arritje vërtetë të rëndësishme si dhe shumë dukuri të tjera të qënësishme për një komb, si nderimi i dëshmorëve të rënë për liri, përkujtimet monumentale të tyre apo të figurave historike kombëtare, ruajtja e disa traditave dhe e pasurisë së krijimtarisë folklorike, etj., nuk do t'i shpëtonin dot përdorimit të tyre nga partia-shtet për qëllimet propagandistike të legjitimitetit të saj. Përparësia ideologjike dhe politike do të diktonte me praninë e saj dizenjimin e modernizimit të Shqipërisë, industrializimin e territorit të saj, zhvillimin demografik të popullsisë, zhvillimin e qyteteve e të banesave, arkitekturën dhe hapësirën publike, strukturimin klasor të shoqërisë, barazitizmin e nivelit të jetesës, dhe të çdo gjëje tjetër, që u konceptua e u materializua nën hijen e pushtetit partiak dhe më shumë në shërbim të tij se të shtetasve.

Kudo që përpiqemi të depërtojmë në këtë të kaluarën tonë të afërt, ndeshim dhe shohim strukturën totalitare partiako-shtetërore të mbrendësuar në të. Pasi totalitaritetet shtetëror do të thotë kontroll në çdo gjë; do të thotë “*Qendër*” në kuptimin e autoritetit partiak, që imponohet dhe ngulitet thellë e shtrihet deri në skajet më periferike me diktatin e saj absolut; do të thotë moral komunist që propagandon sakrificat e privimet dhe shpërfill luksin e jetës e komoditetin material; do të thotë uniformitet, standartizim e thjeshtësi deri në varfëri ekonomike dhe estetike njëkohësisht.

Referenca

1. Chirot D. - "What Happened in Eastern Europe in 1989?", në *The Crisis of Leninism and the Decline of the Left*, University of Washington Press, Seattle, 1991, fq. 9-10. Shih: Tarifa F. - "Socializmi shqiptar dhe Perëndimi", në *gazetadita.al* gusht 11, 2017
2. Gentile E. - *Fetë e Politikës-mes demokracive dhe totalitarizmave*, sh.b. Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2017, fq. 218.
3. Lelaj O. - *Nën shënjën e Modernitetit*, sh.b. Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2015, fq. 42.
4. Lelaj O. - *Nën shënjën e Modernitetit*, ..., fq. 103.
5. Lefebvre H. - *De l'Etat*, Union Generale d'editions, Paris, 1978.
6. Kligman G. & Verdery K.- *Pesants under Siege: The Collectivization of Romanian Agriculture, 1949 -1962*, Oxford & Princeton: Princeton University Press, 2011.
7. Lelaj O. - *Nën shënjën e modernitetit*, ..., fq. 97.
8. Schnell F. - "What is Stalinism?", në *The Call for Freedom*, botuar nga KAS Albania&Maluka, Tiranë, 2016, fq. 46.
9. Rago P.- "The main lines of Enver Hoxha's communism", në *The Call for Freedom*, botuar nga KAS Albania&Maluka, Tiranë, 2016, fq. 77.
10. Misha P. - *Arratisja nga burgjet e historisë. C'do të thotë sot të jesh shqiptar*, sh.b. Toena, Tiranë, 2008, fq. 57.
11. Fuga A. - *Shtigje drejt guvës së gjarprit*, sh.b. Ora, Tiranë, 2004, fq. 86.
12. Rago P. - "The main lines of Enver Hoxha's communism", ..., fq. 77.
13. *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, neni 2, sh.b. 8 Nëntori, Tiranë, 1976, fq. 9.
14. Bardhoshi N.& Lelaj O. - *Etnografi në Diktaturë, Dija, Shteti dhe Holokausti Ynë*, ..., fq. 68.
15. Arendt H. - *Origjina e Totalitarizmit*, sh.b. Dija, Prishtinë, 2002, fq. 503.
16. Arendt H. - *Origjina e Totalitarizmit*, ..., fq. 581.
17. KodraR. - "Nga imazhi simulakral i artistit, në imazhin monumental të pushteti politik", në revista *AKS*, maj 2018.
18. Partia Komuniste e Shqipërisë (PKSH), e themeluar më 1941 e ruan këtë emër deri në vitin 1948, ku në kongresin e parë të saj e në vijimësi do të marrë emrin Partia e Punës së Shqipërisë (PPSH).
19. *Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë*, neni 3 dhe 25, sh.b. 8 Nëntori, Tiranë, 1976, fq. 10,19.
20. Lelaj O. - *Nën shënjën e Modernitetit*, fq. 104.
21. Arendt H. - *Origjina e Totalitarizmit*, fq. 581.
22. Aliaj B. - Co-PLAN: "Housing Models in Albania between 1945-1999", në *ENHR/MRI Conference*, 1996.
23. Fabretti E. – "Le particolarita del comunismo di Hoxha", në *Faturibili*, n.2, 1977, fq. 183.